

Sektor i veprave civile të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të nenit 68 nga Rregullorja gjyqësore (Gazeta Zyrtare e RM nr.66/2013 dhe 114/2014) dhe neni 31, neni 32 dhe neni 33 të Rregullores për punën e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut (Gazeta Zyrtare e RMV nr.14/2022), duke vepruar mbi kërkesën për miratimin e mendimit juridik për shkak të unifikimit të praktikës gjyqësore, në seancën e mbajtur më 09.10.2023, përcaktoi si vijon:

MENDIM JURIDIK

Punëtori ka të drejtë të rrogës shtesë vetëm në qoftë se janë të plotësuar kushtet e shënuara ligjore në mënyrë të përmbledhur, përkatësisht që ka punuar mbi 150 orë më shumë se orari i plotë i punës, e që nuk ka munguar nga puna më shumë se 21 ditë pune gjatë një vitit, në të cilin nuk llogariten ditët e pushimit të shfrytëzuar vjetor, vetëm nëse ka punuar te i njëjti punëdhënës gjatë vitit.

A r s y e t i m

Në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Sektorin e veprave civile, është dorëzuar parashtresë me të cilën tregohet për parregullsi, kontradikta dhe vendime të kundërta të Gjykatës së Apelit Shkup dhe Gjykatës së Apelit Shtip, sa i përket një çështjeje të njëjtë juridike, më saktë zbatimin e nenit 117 paragrafi (4) të Ligjit për marrëdhënie pune, në mënyrë që në shtojcë janë vendosur edhe vendimet e gjykatave të theksuara.

Gjykata Supreme, përmes Sektorit të veprave civile, e siguroi praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit Manastir dhe Gjykatës së Apelit Gostivar, sa i përket zbatimit të nenit 117 paragrafi (4) të Ligjit për marrëdhënie pune, dhe me analizën e parashtresës, si dhe vendimet e dërguara gjyqësore nga gjykatat e apelit, konstaton se:

Bëhet fjalë për disa kërkesëpadi me të cilat paditësit kërkojnë rrogë shtesë për punën jashtë orarit, për shkak të mbi 150 orëve të punuara më shumë se orari i plotë i punës, për periudhën prej 01.01.2019 deri më 31.08.2019, ashtu që ka vazhduar të punojë te një punëdhënës tjetër, e që nuk kanë mungesa, pushime mjekësore dhe as nuk kanë marrë ditë jo pune, që e dëshmojnë me mendimin dhe konstatimin e personit ekspert në bazë të dokumentacionit të të paditurit-punëdhënësit. Ka të bëjë për padi të parashtruara me bazë të njëjtë juridike, rrethana identike, të paditur identik – punëdhënës.

Gjykata e Apelit Shkup, duke vendosur mbi ankesën e të paditurit, të njëjtën e aprovon, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ndryshon dhe vendos në mënyrë që e refuzon kërkesëpadinë e paditësit në emër të rrogës shtesë për realizimin e orëve të punuara jashtë orarit në vitin 2019. Në arsyetimin e vendimeve të dërguara në këtë gjykatë të apelit tregohet për zbatimin e gabueshëm të nenit 117 paragrafi (4) të LMP nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Në vendimet, gjykata ka sqaruar se paditësi nuk i ka plotësuar kushtet në mënyrë të përmbledhur që i shënon neni i theksuar, përkatësisht paditësi nuk ka punuar gjatë tërë një viti kalendarik te i njëjti punëdhënës, për të cilin ka të bëjë kërkesa, por deri më 31.08.2019, në mënyrë që ka vazhduar të punojë te një punëdhënës tjetër.

Gjykata e Apelit Shtip, në një çështje të njëjtë juridike, duke vepruar mbi ankesën e të paditurit, të njëjtën e refuzon dhe e konfirmon aktgjykimin e shkallës së parë me të cilin është aprovuar kërkesëpadia e paditësit në emër të rrogës shtesë për shkak të orëve të realizuara jashtë orarit të punës në vitin 2017, 2018 dhe 2019. Në arsyetimin e vendimit është shprehur qëndrim se edhe pse paditësi gjatë muajit shtator 2019 është punësuar te një punëdhënës tjetër, në Agjencinë për sigurim nacional, nga mendimi dhe konstatimi i personit ekspert buron se deri më 31.08.2019, paditësi te i padituri ka realizuar mbi 150 orë jashtë orarit të punës, për të cilën i padituri ka për detyrë që t'i paguajë rrogë shtesë.

Gjykata e Apelit Manastir, ankesën e të paditurit e aprovon dhe aktgjykimin e shkallës së parë lidhur me kërkesëpadinë për pagesën e rrogës shtesë për vitin 2019 e ndryshon dhe vendos në mënyrë që e refuzon kërkesëpadinë e paditësit. Gjykata e shkallës së dytë konstaton se është zbatuar gabimisht e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë, duke qenë se paditësi nuk i ka plotësuar në tërësi kushtet për pagesën e rrogës shtesë nga ana e të paditurit. E theksuara për shkak që paditësi ka punuar te i padituri deri më 31.08.2019, e jo deri në fund të vitit, ngase nga data 01.09.2019 ka qenë i punësuar te një punëdhënës tjetër, në Agjencinë për sigurim nacional, që është subjekt i veçantë juridik. Kjo gjykatë edhe në aktgjykimin ku si i paditur paraqitet një subjekt tjetër juridik, ka shprehur qëndrim se paditësit nuk i takon rrogë shtesë për shkak që paditësi nuk ka punuar në vazhdimësi pandërprerë gjatë tërë vitit kalendarik te i padituri, në mënyrë që nuk e ka plotësuar kushtin e nenit 117 paragrafi (4) të LMP.

Gjykata e Apelit Gostivar, në një çështje të njëjtë juridike, duke vepruar mbi ankesën e të paditurit, të njëjtën e refuzon dhe e konfirmon aktgjykimin e shkallës së parë me të cilin është aprovuar kërkesëpadia e paditësit në emër të rrogës shtesë për shkak të orëve të realizuara jashtë orarit të punës në vitin 2019. Kjo gjykatë, në përgjigje të të dhënave ankimore, ka shprehur qëndrim se i padituri është i legjitimuar pasiv duke qenë se paditësi të drejtën e shtesës e ka realizuar derisa ka punuar te i padituri, kur ka punuar mbi 150 orë jashtë orarit të punës. Dukshëm nga ankesa e deklaruar e të paditurit, si dhe në lëndët tjera, paditësi ka punuar te i padituri deri më 31.08.2019, kur ka kaluar te një punëdhënës tjetër, në Agjencinë për sigurim nacional, që është subjekt i veçantë juridik.

Nga analiza e sipër theksuar e vendimeve të gjykatave të apelit, u arrit në përfundim se ka interpretim të ndryshëm të gjykatave sa i përket zbatimit të dispozitave të nenit 117 paragrafi (4) të LMP. Më saktë, ka interpretim në dispozitën e paragrafit (4) lidhur me të shënuarën “gjatë një viti te i njëjti punëdhënës”, përkatësisht se a duhet që punëtori të punojë te i njëjti punëdhënës gjatë tërë një viti kalendarik për të cilin kërkon realizimin e të drejtës për shtesë, apo pa dallim sa është periudha gjatë vitit ka punuar te i njëjti punëdhënës në qoftë se ka punuar mbi 150 orë gjatë nga orari i plotë i punës dhe nuk ka munguar nga puna më shumë se 21 ditë do të thotë se punëtorit i takon e drejta për shtesë.

Spektori i veprave civile të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke shqyrtuar mbi çështjen për zbatimin e nenit 117 paragrafi (4) të Ligjit për marrëdhënie pune, miratoi mendim juridik, për këto shkaqe:

Sipas nenit 117 paragrafi (1) të Ligjit për marrëdhënie pune (“Gazeta Zyrtare e RM” nr.62/2005.... “Gazeta Zyrtare e RMV” nr.111/23), punëtori obligohet që me kërkesë të punëdhënësit të kryejë punën përmes orarit të plotë të punës (jashtë orarit të punës):

- 1) në rast të zmadhimit ekskluziv të vëllimit të punës;

- 2) nëse nevojitet vazhdimi i procesit të punës ose të prodhimit;
- 3) nëse është e domosdoshme, të mënjanohet dëmtimi i mjeteve të punës, që do të shkaktonte ndërprerjen e punës;
- 4) nëse nevojitet, të garantohet siguria e njerëzve dhe pronës si dhe siguria e qarkullimit dhe
- 5) në raste të tjera të përcaktuara me ligj ose marrëveshje kolektive.

Me paragrafin (2) nga i njëjti nen është shënuar se puna jashtë orarit mund të zgjasë më së shumti tetë orë gjatë një jave dhe më së shumti 190 orë në vit, përveç për punët të cilat për shkak të procesit specifik të punës nuk mund të ndërpriten apo për të cilat nuk ka kushte dhe mundësi të organizohet puna në ndërresa. Puna jashtë orarit gjatë një periudhe tre mujore nuk mund të kalojë mesatarisht tetë orë në javë.

Me paragrafin (3) nga i njëjti nen është paraparë për punëtorët nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe punëtorët nga Agjencia për sigurim nacional, që kryejnë detyra dhe autorizime të posaçme sipas ligjeve të posaçme, puna jashtë orarit të punës mund të zgjasë më shumë se 190 orë në vit, për shkak të kryerjes së punëve urgjente dhe që nuk shtyhen, pas pëlqimit me shkrim paraprakisht të dhënë të punëtorit.

Sipas paragrafit (4) nga i njëjti nen, punëtorit që ka punuar mbi 150 orë më gjatë se orari i plotë i punës, e nuk ka munguar nga puna më shumë se 21 ditë gjatë një viti, të punëdhënësi i njëjtë ku nuk llogariten ditët e pushimit të shfrytëzuar vjetor, punëdhënësi obligohet që t'i paguajë përveç shtesës në rrogë edhe rrogë shtesë në lartësinë e një rroge mesatare në Republikë.

Punëdhënësi, sipas paragrafit (5) nga i njëjti nen, obligohet të mbajë evidencë të posaçme për punën jashtë orarit të punës dhe orët për punën jashtë orarit të punës veçanërisht duhet t'i theksojë në llogarinë mujore të rrogës së punëtorit.

Nga neni i cituar 117 të Ligjit për Marrëdhëniet e Punës edhe atë paragrafi (4), buron ajo se, që punëtori të mund të realizojë të drejtën e pagesës së shtesës, ligjvënësi ka shënuar plotësimin e kushteve të parapara në mënyrë të përmblodhur.

Duke qenë se kërkesëpadia i referohet punëdhënësit, të i cili punëtori i ka realizuar orët jashtë orarit të punës, parashtrohet pyetja nëse të ai punëdhënësi punëtori nuk ka punuar gjatë tërë një viti për të cilin kërkon realizimin e të drejtës së shtesës, a mundet që me mendimin dhe me konstatimin e përgatitur vetëm nga dokumentacioni i atij punëdhënësi të konstatohet se punëtori nuk ka munguar nga puna më shumë se 21 ditë gjatë një viti, ku sipas dispozitës ligjore nuk llogariten vetëm ditët e pushimit vjetor të shfrytëzuar. Dhe kjo është një ndër mënyrat e përmblodhura të kushteve për fitimin e të drejtës së shtesës.

Gjatë miratimit të mendimit juridik, dhe duke qenë se bëhet fjalë për konteste të marrëdhënies së punës kundër të njëjtit të paditur – punëdhënësi i paditësve, Ministria e Punëve të Brendshme, Sektori i veprave civile të GJSRMV, i ka marrë parasysh edhe këto dispozita:

Me nenin 102 paragrafi (1) të Ligjit për policinë shënohet se nëpunësi i policisë detyrimisht sipas urdhrorit të nëpunësit udhëheqës të drejtpërdrejtë policor, punët policore duhet t'i kryejë edhe më gjatë se orari i plotë i punës, nëse kjo është e domosdoshme për shkak të kryerjes së tyre të suksesshme dhe në kohë. Sipas paragrafit (2) nga i njëjti nen,

nëpunësit policor për punën e kryer më gjatë se orari i plotë i punës i takon kompensim në para ose ditë të lira, në përputhje me dispozitat për marrëdhënie pune.

Sipas nenit 169 të Marrëveshjes Kolektive të Ministrisë së Punëve të Brendshme, shtesa e rrogës për punën e jashtëzakonshme paguhet për punë më të gjatë se puna me orar të plotë – punë jashtë orarit.

Sipas nenit 170 nga e njëjta Marrëveshje Kolektive, shtesë të rrogës për punë të jashtëzakonshme paguhet për komponentin bazë të rrogës së punëtorit. Shtesë të jashtëzakonshme të rrogës paguhet për një orë në lartësinë prej 40%.

Me nenin 171 nga e njëjta Marrëveshje Kolektive, shënohet se shtesë të rrogës për punën e jashtëzakonshme paguhet për 32 orë të punuara jashtë orarit të punës në muaj. Në vend të rritjes së rrogës sipas paragrafit (1) të këtij neni, me pëlqimin e punëtorit mund të përcaktohet që i njëjti të shfrytëzojë ditë të lira. Në qoftë se punëtori punon më shumë se 32 orë jashtë orarit të punës në muaj, për orët tjera (mbi 32 orë) kryesisht shfrytëzon ditë të lira. Shfrytëzimi i ditëve të lira llogaritet në atë mënyrë që orët e punës së realizuara rriten për 40%, dhe pastaj ndahen me numrin e orëve të punës në një ndërresë (tetë orë) përkatësisht gjashtë orë jashtë orarit të punës zëvendësohen me një ditë të lirë. Ditët e lira nga paragrafi (3) të këtij neni, të cilat punëtori nuk i ka shfrytëzuar gjatë një viti kalendarik, mund t'i shfrytëzojë më së voni deri më 30 qershor vitin ardhshëm kalendarik.

Sipas nenit 172 nga e njëjta Marrëveshje Kolektive, mënyra e evidentimit të orëve të realizuara jashtë orarit të punës, punën e natës, punën të dielën, punën gjatë festave të përcaktuara me ligj, punën në ndërresa, si dhe mënyrën e plotësimit të listave mujore për evidencën e orëve të punës në Ministrinë kryhet sipas një akti të posaçëm të brendshëm nga Ministri.

Nga të gjitha dispozita e sipër cituara, pa diskutim është se me nenin 117 të LMP shënohet puna jashtë orarit, dhe me Ligjin e policisë si *lex specialis* dhe Marrëveshjen Kolektive, në detaje janë parashikuar të drejtat e punëtorit sa i përket punës jashtë orarit, në mënyrë të llogaritjes dhe lartësisë së kompensimit në para, si dhe ditëve të lira, e gjithë kjo në bazë të obligimit për punëdhënësin mbi evidentimin e orëve të punës jashtë orarit dhe futjen e tyre në listat mujore.

Duke marrë parasysh orët e njëjta të punës jashtë orarit, ligjvënësi e ka parashikuar në nenin 117 paragrafi (4) të LMP, edhe të drejtën e shtesës, për plotësimin e kushteve siç ka parashikuar paragrafi i cituar, mund të bëhet fjalë vetëm në qoftë se punëtori gjatë një viti për të cilin kërkon realizimin e kësaj të drejte, ka punuar te i njëjti punëdhënës.

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut
Sektori i veprave civile